



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 56

Prishtinë, më 24.3.2016, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj, Armend Zemaj dhe Milena Miliqeviç.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Berisha, OSBE; Dren Ajeti, GLPS; Floriana Merovci, ZPRK; Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Valon Qyqalla dhe Kosovare Maliqi, Rrokum TV; Mehreme Tahirukaj, Radio Kosova; Rinor Hoxha, MIE; Agon Foniqi, gazeta "Kosova Sot"; Ismail Shabani, "Kosova Press"; Ardian Bajraktari, MD; Albert Avdiu, KGJK dhe Gentiana Azemi, prakticante.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033, si dhe Ligjin nr. 04/L-115;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033, si dhe Ligjin nr. 04/L-115;

Komisioni e shqyrtoi shkesën e Kryeministrit, të datës 23.3.2016, me të cilën kërkohet përshpejtimi i procedurave për shqyrtim dhe miratim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033, si dhe Ligjin nr. 04/L-115 dhe lidhur me këtë vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Amendament

- I. Të plotësohet rendi i ditës, i mbledhjes plenare të Kuvendit, të datës 24 mars 2016, me pikën e re, si vijon:
Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033, si dhe Ligjin nr. 04/L-115.

Rekomandim

- II. 1. I rekomandohet Kuvendit, shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e parë dhe të dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033, si dhe Ligjin nr. 04/L-115.
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit, të bëhet në Seancën plenare të datës 24.3.2016 dhe shqyrtimi i dytë të bëhet në Seancën e re plenare, ditën e sotme, më 24.3.2016.

3. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 9:40.

E hartoi:

Visar Krasniqi

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi